



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5139 Prot.

Elbasan, më 02.12.2025

VENDIM

Nr. 140 datë 27.11.2025

***“PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË ELBASAN
PËR VITIN 2026”***

KËSHILLIT BASHKIAK, ELBASAN

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës __.__.2025, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Administrata dhe Kryetari i Bashkisë “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2026”, bazuar në:

- ✓ Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për liçensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin e veterinarisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 57/2020, “Për pyjet”; i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;

- ✓ Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”;
- ✓ Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- ✓ Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; i ndryshuar;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/ bashkive”;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe për dhënien në shfrytësim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtarie ekonomike dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurën e mbledhjes së tyre”;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 179, datë 09.03.2016 “Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 11.06.2009 “Për tarifat në sektorin e Kullotave”;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011 “Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 04.01.2012 “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”, i ndryshuar;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 03.06.2015, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave në Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”, i ndryshuar;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 12.10.2016 “Për tarifën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të ofruar nga bashkitë e pajisura me stacione të këtij shërbimi, në territorin e bashkive që nuk kanë stacione të shërbimit të MZSH-së”;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 09.11.2016 “Për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruar nga zjarri dhe administrimin e përdorimin e të ardhurave, për llogari të shërbimit vendor MZSH-së”;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 607, datë 29.07.2020 “Për tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”;

PROPOZON:

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2025

“PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË ELBASAN PËR VITIN 2026”

Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat “c” dhe “ç”, dhe pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja “b”, nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja “f”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

PJESA E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky vendim përcakton llojet e taksave dhe tarifave vendore që zbatohen në territorin e Bashkisë Elbasan. Nivelin e taksave dhe tarifave, procedurat e llogaritjes, baza tatimore të llogaritjes, kategorizimet dhe nën kategorizimet, lehtësimet apo përjashtimet, arkëtimet dhe transferimet në buxhetin e bashkisë, si dhe detyrimet që kanë agjentët për mbledhjen e taksave dhe tarifave.

KREU I

TAKSAT

Neni 2

Llojet e taksave

1. Në Bashkinë Elbasan aplikohen këto taksa vendore:

- a.Taksa mbi pasurinë e paluajtshme**, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin (jo hapësirë publike);
- b.Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;**
- c.Taksë për objektet në proces legalizimi;**
- ç.Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;**
- d. Garancia financiare për heqjen e inerteve;**

e.Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;

f.Taksa e fjetjes në hotel;

g.Taksa e tabelës.

2. Përfshihen nga taksat vendore të gjitha subjektet e parashikuara shprehimisht në këtë vendim, apo në akte ligjore dhe nënligjore të veçanta.

KREU II

TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Neni 3

Taksa mbi pasuritë e paluajtshme

1. Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mëposhtme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:
 - Taksa mbi ndërtesat.
 - Taksa mbi tokën bujqësore.
 - Taksa mbi truallin (jo hapësirë publike).

Neni 4

Përkufizime

Në këtë vendim, termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

Agjent i mbledhjes së taksave dhe tarifave, është personi i cili, sipas kërkesave të këtij vendimi, është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogarinë e Bashkisë Elbasan apo strukturave të saj, të të ardhurave nga taksat dhe tarifat.

Pasuri e paluajtshme, janë trualli, toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

Kadastra fiskale, është regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.

Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregjeve, është struktura për administrimin e taksave dhe tarifave vendore pranë Bashkisë Elbasan.

Niveli tregues i taksës, janë nivelet e taksave të parashikuara sipas Ligjit 9632/2006, si dhe sipas këtij vendimi.

Çmim vlerësues, njësia matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar sipas VKM nr. 132, i ndryshuar.

Ndërtesë, objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqësojnë një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në vendim.

Truall, është pasuria e paluajtshme e emërtuar e tillë sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

Ndërtesë e papërfunduar, është objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Njësi pronësore, është ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”. Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.

Ndarje e njësisë pronësore për banim, është pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.

Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike është pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.

Përdorues, është individ, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/ njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.

Taksë, është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e Bashkisë Elbasan që paguhet nga çdo person apo nëpërmjet një agjenti, për ushtrimin e një të drejte publike apo përfitimin e një shërbimi publik në territorin e Bashkisë Elbasan.

Tarifë, është pagesa, që një individ, person fizik apo juridik, bën drejtpërdrejt apo nëpërmjet një agjenti tek administrata e Bashkisë Elbasan. Pagesa bëhet në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë.

Taksapagues, është çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, i cili është i detyruar të paguajë njëren nga taksat vendore të përcaktuara në këtë vendim apo legjislacionin në fuqi.

Vlerë e pasurisë, është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore.

Veprimtari ekonomike, është çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

Neni 5

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesë”

1. Përcaktimi i vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”/njësi pronësore bazohet mbi prioritetet e vlerësimit duke ndjekur një radhë të caktuar.
2. Baza e vlerësimit mbështetet tek vetdeklarimi, ku çdo taksapagues duhet të vetdeklarojë të dhënat mbi pasurinë e tij të paluajtshme “ndërtesë”/njësi pronësore që ka në pronësi apo përdorim. Vetëdeklarimi bëhet pranë zyrave të Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregjeve, për të marrë dhe për të përpunuar informacionin e vetëdeklarimit të taksapaguesit, për qëllim të zbatimit të legjislacionit përkatës të taksës mbi pasurinë e paluajtshme. Në rast se vlera e vetëdeklaruar nga taksapaguesi rezulton e ndryshme nga vlera e llogaritur me çmim e vlerësuar, të përcaktuar me këtë metodologji, si vlerë e bazës së taksës do të merret vlera më e lartë.
3. Për taksën e pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, për të cilat nuk disponohet vlera e ndërtesës, do të përdoret vlera referuese për sipërfaqje të banesës, 100 (njëqind) metër katror sipërfaqje për njësi pronësore për ndërtesat për banim dhe 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqje për njësi pronësore, për ndërtesat për banim të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar ose të ndërtuara para vitit 1991 në Njësitë Administrative. Për ndërtesat e tjera, të cilat nuk shërbejnë për qëllime banimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës. Kur gjatë verifikimeve në terren konstatohen dëmtime të ndërtesave për shkaqe të fatkeqësive natyrore (tërmet/zjarr/përmbytje etj.), të cilat ndryshojnë vlerën e kësaj pasurie, njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas rastit që i paraqitet, ngre një komision, i cili vlerëson dhe korrekton vlerën e ndërtesës. Vlerësimi bëhet sipas gjendjes fizike në të cilën paraqitet ndërtesa e dëmtuar.
4. Përsa i përket kategorisë së ndërtesave që përdoren, shfrytëzohen për veprimtari ekonomike nëse subjekti nuk ka realizuar deklarimin nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë vlerësimi realizohet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar”.

Neni 6

Shkalla e taksës mbi ndërtesat

1. Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si mëposhtë:

- 1.1. 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- 1.2. 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- 1.3. 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Neni 6/1

Për ndërtesat të cilat shërbejnë për banim

1. Shkalla e taksës për sipërfaqje ndërtesë banesë në qytet është 0.05% e çmimit mesatar referues (Shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 1\ m^2 \times 0,05\ \% \times 50.300^1 = 25.15\ lekë$).
2. Aplikohet ulja e taksës me 30% të çmimit mesatar referues për sipërfaqjet ndërtesë banesë në të gjitha Njësitë Administrative (çmimi nga 50,300 shkon në 35,210) (Shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 1\ m^2 \times 0,05\ \% \times 35,210 = 17.605\ lekë$).

Neni 7

Për ndërtesat të cilat nuk shërbejnë për banim

1. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi, shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqjes së banimit. Në këtë kategori do të përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi ose/edhe shërbime me pakicë. (Shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 1\ m^2 \times 0,2\ \% \times 75,450 = 150,9\ lekë$).
Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi/njësi ku nuk kryhet aktivitet ekonomik është **120.7** lekë/m² në vit.
2. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70% (shtatëdhjetë %) e çmimit të sipërfaqjes së apartamenteve të banimit. (Shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 1\ m^2 \times 0,2\ \% \times 35,210 = 70.42\ lekë$).
3. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqjen e shtrirë që ato zënë, është 30% (tridhjetë %) e çmimit të sipërfaqjes së apartamenteve të banimit (Shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 1\ m^2 \times 0,2\ \% \times 15,090 = 30.18\ lekë$).

¹50300 është çmimi për m² për ndërtesë banesë në qytet.

4. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshirë ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50% (pesëdhjetë%) e çmimit të sipërfaqjes së banesave të zonës përkatëse për Bashkinë Elbasan.

Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura.” (Shembull: Vlera për $m^2 = 1 m^2 \times 0,2 \% \times 25,150 = 50.3$ lekë).

5. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është 30% (tridhjetë%) e çmimit të sipërfaqjes së banesave, me përjashtim të përpunimit ushqimor (Shembull: Vlera për $m^2 = 1 m^2 \times 0,2 \% \times 15,090 = 30.18$ lekë).

Neni 8

Modalitete

1. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesë” llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit.
2. Për regjistrimin për herë të parë të ndërtesave/njësive pronësore ose nëndarjeve të saj në mungesë të dokumentacionit të vetdeklaruar nga subjektet do të realizohet verifikimi në terren. Vetëvlerësimi i ndërtesës/njesisë pronësore do të bëhet mbi sipërfaqen e verifikuar në terren.
3. Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambjentit të ndërtesës.
4. Në rast se një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie, pavarësisht nga vendbanimit i pronarit, secila njësi vendore e trajton pjesën e pronës, që ndodhet brenda territorit të vet, si pronë më vete dhe zbaton mbi të dispozitat e këtij ligji.
5. Taksapaguesi, në çdo kohë, kur gjykon se vlerësimi i pasurisë së tij të paluajtshme ndërtesë, objekt taksimi, është jo i saktë, ka të drejtë të kërkojë korrigjimin e detyrimit. Taksapaguesi, pas marrjes së njoftimit të detyrimit për taksën e pasurisë, kur nuk është dakord me këtë vlerësim, ka të drejtë të bëjë kërkesë për korrigjimin e vlerës pranë D.T.T.V.T. duke paraqitur dokumentacionin justifikues. E drejta ose jo e korrigjimit të vlerës përfundimtare të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë” do të përcaktohet pas shqyrtimit të ankimit nga Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregjeve, brenda 30 ditëve.
6. Nëse edhe pas marrjes së përgjigjes në lidhje me të drejtën e korrigjimit, taksapaguesi nuk bie dakord me qëndrimin e zyrës tatimore pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, ai ka të drejtë që, bazuar në nenin 7, “Ankimimi”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, t’i drejtohet strukturës vendore të ngritur pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore. Struktura e Drejtorisë Juridike jep qëndrimin e saj brenda afatit ligjor të parashikuar në legjislacionin tatimor.

Neni 9

Afati dhe struktura e caktuar për vjeljen e taksës së ndërtesës

1. Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregjeve, për taksën e biznesit të madh dhe të vogël (pagesa kryhet nëpërmjet çdo banke të nivelit të dytë, shoqërisë “Posta Shqiptare sh.a.” ose Unioni Financiar Tiranë). Për vjeljen e taksës së ndërtesës biznesit të madh dhe biznesit të vogël ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. (Pagesa kryhet nëpërmjet çdo banke të nivelit të dytë, shoqërisë “Posta Shqiptare sh.a.” ose Unioni Financiar Tiranë).
2. Për subjektet familje të cilat disponojnë kontratë me shoqërinë “SHRUKË sh.a.” pagesa e taksës bëhet çdo muaj si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë nga kjo ndërmarrje, në cilësinë e agjentit tatimor (taksat e popullatës për vitin 2026 dhe detyrimet e prapambetura për klientët e faturuar).
3. Për subjektet familje të cilat nuk disponojnë kontratë furnizimi me ujë me shoqërinë “SHRUKË sh.a.” afati i pagesës është data 30.09.2026. Struktura e caktuar për mbledhjen e kësaj takse janë administratorët në Njësitë Administrative dhe Lagjet.
4. Afati i pagesës së taksës së ndërtesës nga subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik do të jetë data **31.07.2026**.
5. Afati i pagesës së taksës së ndërtesës për subjektet të cilëve iu është bërë rivlerësim pas datës 31.07.2026, do të jetë data **25 e muajit pasardhës**.
6. Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet kamatëvonesë në masën 1.8% çdo muaj, por jo më shumë se 12 muaj.

Neni 10

Lehtësira dhe përjashtimet nga taksa e ndërtesës

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesën:

1. Pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
2. Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me V.K.M., nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
3. Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
4. Banesat sociale në pronësi të Bashkisë;
5. Pasuritë e paluajtshme “ndërtesa”, pronë e subjekteve juridikë ose fizikë, që në bazë të marrëveshjeve me Bashkinë përdoren nga kjo e fundit si banesa sociale;
6. Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
7. Strukturat akomoduese “hotel / resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;
8. Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
9. Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

10. Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ ose trashëgimisë kulturore të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse;
11. Ndërtesat e invalidëve të punës kur janë kryefamiljarë, pas paraqitjes së dëshmisë së invaliditetit, në ato raste kur familja përbëhet vetëm nga invalidi, ose dhe nga persona në ngarkim të tyre të paaftë për punë ose pensionistë;
12. Përfshihen nga taksa e ndikimit në infrastrukturë investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese me 5 yje, "status special", sipas përcaktimit në legjislacionin përkatës për fushën e turizmit.
13. Në qoftë se ndërtesa dëmtohet nga forca madhore, përjashtohet nga taksa e ndërtesës në masën 75% të vlerës.
14. Kur ndërtesa tjetërsohet ose zhduket gjatë vitit, detyrimi llogaritet për periudhën që gëzon statusin e pronarit.

Neni 10/a

Dokumentacioni nevojshëm për përfitimin nga përjashtimi mbi taksën e ndërtesës

Kategoritë e përcaktuara në pikat 1,2 dhe 3 të nenit 36, për të përfutur këtë përjashtim, duhet të dorëzojnë pranë Sektorit të taksave dhe tarifave familjare, zyrave të Njësive Administrative dhe Lagjeve të Bashkisë Elbasan sipas rastit dokumentet si vijon: marrin pension pleqërie/pension social;

- ✓ janë kryefamiljarë që kanë në përbërje të familjes vetëm pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre të paaftë për punë;
- ✓ trajtohen me ndihmë ekonomike;
- ✓ kopje të dokumentit ku banojnë që provon se janë pronarë apo përdorues të pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës etj;
- ✓ kopje të kontratës/ librezës/ faturës së abonentit kryefamiljar që bën kërkesën për përjashtim.

KREU III

TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Neni 11

Baza dhe llogaritja e detyrimit

1. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të kasapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë pronësinë.
2. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.
3. Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të kasapaguesit, janë të vlefshme dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrat të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në rast mungese të dokumentacionit ligjor verifikimi bëhet nga komisioni i verifikimit të pasurive të paluajtshme i ngritur për këtë qëllim.

4. Përbërja e Komisionit dhe rregullat për funksionimin e tij përcaktohen me Vendim ose Urdhër nga Kryetari i Bashkisë. Komisioni verifikon vërtetësinë e vetëdeklarimit të sipërfaqes së tokës bujqësore të dorëzuar nga subjekti taksapagues.

Neni 12

Niveli i taksës

1. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar.
2. Niveli i taksës mbi tokën bujqësore sipas kategorive është sipas tabelës **Aneksi nr. 1** që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë që mbulon çështjet e bujqësisë.

Neni 13

Struktura dhe afati për vjeljen e taksës së tokës bujqësore

1. Strukturat e caktuara për mbledhjen e kësaj takse janë:
 - a. Sektori i Taksave dhe Tarifave Familjare, Njësitë Administrative dhe Lagjet;
 - b. Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale; Njësitë Administrative.
2. Afati për pagesën e taksës së tokës bujqësore është data **30.09.2026**.

Neni 14

Përfshirjet nga taksat e tokës bujqësore

1. Përfshihen nga taksimi mbi tokën bujqësore sipërfaqet e mbjella me kulturat dru frutor dhe vreshtari për 5 vitet e para nga momenti i mbjelljes, pas paraqitjes së dokumentacionit që vërteton faktin e mbjelljes dhe sipërfaqen përkatëse.
2. Kur toka bujqësore dëmtohet nga fatkeqësi natyrore i zbritet 75 % e vlerës së taksës, për sipërfaqjen e dëmtuar.
3. Në rastet e dëmtimit tërësisht të sipërfaqes së tokës nga gërryeja e lumenjve, përrenjve, rrëshqitjeve masive prej të cilave toka humb tërësisht funksionin e saj si tokë bujqësore ngrihet një komision nga Bashkia Elbasan, prej drejtorisë përkatëse të bujqësisë dhe përpilohet procesverbali, ku merr pjesë edhe përfaqësuesi nga seksioni i mbrojtjes dhe menaxhimit të tokës bujqësore të Këshillit të Qarkut. Në këtë rast qytetari përfshihet nga detyrimi për pagesën e taksës mbi tokën bujqësore, nga periudha e konstatimit të dëmtimit të tokës e në vazhdim.

KREU IV

TAKSA MBI TRUALLIN

Neni 15

Baza dhe niveli i taksës mbi truallin

1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metra katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.
2. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror në vit.

3. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, janë si më poshtë:
 - a. Vlera e taksës në lekë/m²/vit, për qëllime biznesi është 18 lekë për m²në vit;
 - b. Vlera e taksës në lekë/m²/vit për qëllime banimi nga individët ose troje të tjera me destinacion jo ekonomik, është 0.42 lekë për m² në vit;
4. Për të gjitha kategoritë e truallit që nuk shërbejnë për aktivitet ekonomik do të aplikohet taksa sipas kategorisë 3.b.
5. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim. Vetëdeklarimi i kryer verifikohet nga Struktura Përgjegjëse.

Neni 16

Struktura për vjeljen e taksës mbi truallin

1. Strukturat e ngarkuara për vjeljen e taksës mbi truallin janë:
 - a. Sektori i Taksave dhe Tarifave Familjare në Drejtorinë e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregjeve,
 - b. Njësitë Administrative dhe Lagjet.
2. Afati për pagesën e taksës së truallit për kategorinë 3.a në Njësitë Administrative është data **31.07.2026**.
3. Afati për pagesën e taksës së truallit për kategorinë 3.b në Njësitë Administrative është data **30.09.2026**.
4. Për mos pagesë në afatin e caktuar aplikohet kamatëvonesë 1.8% çdo muaj, jo më shumë se 12 muaj, mbi detyrimin.

KREU V

TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Neni 17

Baza, niveli dhe llogaritja e detyrimit

1. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.
2. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
3. Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
4. Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre.
5. Pagesa e taksës së çdo ndërtimi fillon nga momenti i marrjes së lejes së shfrytëzimit, si detyrim i ndërtuesit. Me paraqitjen e kontratave të shitjes prej tij, detyrimi i lind subjektit blerës të sipërfaqjes së ndërtimit.

6. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
7. Niveli i taksës sipas kategorive, është sipas tabelës **Aneksi nr. 2**, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Neni 18

Përfshirjet nga taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë

Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

1. Enti Kombëtar i Banesave, Ministria përgjegjëse për financat dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
2. Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar;
3. Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
 - a. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
 - b. bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi.

Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga Këshilli Bashkiak apo struktura e deleguar nga ky i fundit për përfshirjen nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

4. Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme të gjitha rastet e tjera të përfshiruara me akte ligjore.

Neni 19

Agjenti tatimor

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Në rolin e agjentit tatimor, Agjencia Shtetërore e Kadastrës përfiton një komision prej 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogari të buxhetit të Bashkisë Elbasan, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

KREU VI

TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Neni 20

Baza dhe niveli i taksës

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
2. Niveli i taksës në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në

masën 4 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkaki zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njërive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerrë me akt nga Këshilli i Ministrave.

3. Për objekte individuale mbi 4 kat, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të jetë 4% e vlerës së shitjes sipas EKB-së.
4. Për strukturat e banimit për ndërtime për banim e shërbime nga investitorë të tjerë për qëllim jo fitimi, niveli i taksës është 3% e vlerës së investimit sipas çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
5. Niveli i taksës për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individit apo me sipërmarrës, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 3% e preventivit real të investimit, me çmimet në bazë të manualit të ndërtimit në fuqi.
6. Niveli i taksës, për strukturat për qëllime publike niveli i taksës është 2% të vlerës së investimit sipas çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
7. Për struktura me funksion privat (prodhime, tregtimi e shërbimi) taksa e ndikimit në infrastrukturë është 3% për qind e vlerës së investimit sipas çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
8. Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të proteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0.1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.
9. Për ndërtesat, që janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0.5 për qind e vlerës së investimit sipas çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
10. Për ndërtesat për të cilat realizohet ndryshimi i funksionit taksa e ndikimit në infrastrukturë është 3% për qind e vlerës së preventivit në bazë të manualit të ndërtimit.
11. Për rikonstruksione e struktura të ndryshme, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 3% për qind e vlerës së preventivit në bazë të manualit të ndërtimit.
12. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të Bashkisë Elbasan, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

Neni 21

Mënyra dhe afati i pagesës së taksës

1. Taksa paguhet dhe ngarkohet në sistemin elektronik të lejeve brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit në sistemin e-leje për pagesën e taksave dhe tarifave nga Drejtoria e Planifikimit të Përgjithshëm dhe të Detajuar Urban. Nëse në përfundim të këtij afati kërkuesi nuk ka paguar dhe ngarkuar aktet që provojnë pagimin e

taksës, autoriteti përgjegjës i dërgon kërkesit, nëpërmjet sistemit elektronik, vendimin për refuzimin e lejes së ndërtimit.

2. Taksa paguhet nga individ/subjekti i interesuar në çdo moment dhe gjithsesi jo më vonë se 45 (dyzetepesë) ditë nga data e dhënies së lejes së legalizimit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Nëse subjekti/personi i interesuar nuk kryen pagesën brenda këtij afati, atëherë për çdo ditë vonesë i llogaritet kamatë 0,1% për qind në ditë e shumës që duhet të paguajë, deri në 30 ditë pune.
3. Për kategoritë ku niveli i taksës aplikohet mbi vlerën e investimit, në përfundim të punimeve të kryera sipas lejes së miratuar, bëhet kontrolli i pagesave me situacionin përfundimtar të objektit të ndërtuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Urban dhe Punëve Publike dhe nëse ka diferenca mes vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar dhe preventivit, njoftohet subjekti për vlerën e diferencës që është i detyruar të shlyejë. Mosshlyerja e këtij detyrimi përbën shkak për pezullimin e procedurave të pajisjes me leje përdorimi të subjektit.

Neni 22

Struktura për përlogaritjen dhe vjeljen e taksës

Struktura e ngarkuar për përlogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Urban dhe Punëve Publike.

Neni 23

Përfshirja nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Përfshihen nga detyrimi i pagesës së kësaj takse:

- a. Investimet e kryera nga Bashkia Elbasan;
- b. investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtur të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- c. investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit. Subjekte që zhvillojnë veprimtari pritëse duhet të jenë certifikuar si “Subjekt i certifikuar agroturizmi”, sipas VKM nr.22, datë 12.01.2018, si kusht për t’u përjashtuar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0%.
- d. Për ndërtesat që destinohen për qëllime banimi në zona malore taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0% për qind të vlerës së investimit sipas vendimeve të Këshillit Bashkiak për përcaktimin e zonave malore për efekt të zbatimit të këtij paragrafi;
- e. Personat që aplikojnë për t’u pajisur me leje për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, përjashtohen nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë duke paraqitur dokumentacionin përkatës sipas VKM nr.145, datë 13.02.2020 është 0% për qind taksa e ndikimit në infrastrukturë.
- f. Për individët që trajtohen nga emergjenca civile për rrëshqitje të tokës ose nga fatkeqësi të tjera natyrore taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0%.

KREU VII

TAKSA PËR OBJEKTET NË PROCES LEGALIZIMI

Neni 24

Taksa për objektet në proces legalizimi

1. Për ndërtesat të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5% e vlerës së investimit.
2. Në rastet kur një subjekt aplikon për legalizimin të më tepër se 1 objekti taksa që aplikohet është:
 - a. Për struktura banimi, 3 % për qind e ndikimit në infrastrukturë.
 - b. Për struktura me funksione shërbimi dhe njësi, 3 % e ndikimit në infrastrukturë.
 - c. Për struktura për qëllime publike si: shkolla, kopshte, spitale etj., (private ose publike), 2% për qind e ndikimit në infrastrukturë.

Neni 25

Struktura për vjeljen e taksës

1. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Urban dhe Punëve Publike.
2. Dokumentacioni i kërkuar do të jetë ai i parashikuar nga drejtoria përkatëse, i cili përfshin kopje të njehësuar të vetëdeklarimit, planvendosje të objektit, si dhe planimetritë me sipërfaqjet përkatëse.

KREU VIII

GARANCIA PËR HEQJEN E INERTEVE

Neni 26

Struktura për vjeljen e taksës

1. Në mbështetje të pikës 10, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, subjekti fizik/juridik, kërkuar i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të Bashkisë Elbasan ose kontratë sigurimi, e cila nuk do të jetë më e vogël se 4% e vlerës së strukturës së objektit.
2. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Urban dhe Punëve Publike.

KREU IX

TAKSA E FJETJES NE HOTEL

Neni 27

Baza dhe niveli i detyrimit

1. Me “hotel” kuptohet çdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet: hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar si dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.
2. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.
3. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
4. Subjektet janë të detyruar të bëjnë vetëdeklarimin e numrit të netëve të qëndrimit në hotel shoqëruar me dokumentacionin justifikues për muajin paraardhës. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë bëhet brenda datës 5 (pesë) të muajit pasardhës. Subjekti detyrohet të paraqitet para datës 5 të muajit për tërheqjen e faturës për arkëtim.
5. Për subjektet “Hotele me 4 dhe 5 yje” që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Elbasanit, niveli i taksës për çdo fjetje është 175 lekë për person, ndërsa për ato që ushtrojnë aktivitetin e tyre në njësitë administrative jashtë qytetit të Bashkisë Elbasan, vlera që duhet të paguhet është 105 lekë për natë fjetje për person.
6. Subjektet “Hotel nën 4 yje”, motel, hostel, bujtinë, si dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Elbasanit, niveli i taksës është 70 lekë për person. Në rastet kur subjektet nuk mbajnë regjistër të klientëve që akomodohen në hotel, administratës tatimore i lind e drejta të bëjë vlerësimin.

Neni 28

Struktura dhe afatet për vjeljen e taksës

1. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregjeve.
2. Në rastin e pikës 6 të nenit 27, detyrimet e prapambetura duhet të kryhen brenda datës **31.07.2026**.
3. Për subjektet me aktivitet “hoteleri” në territorin e njësisë administrative Tregan, afati për pagesën e kësaj takse është data **31.10.2026**.
4. Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet kamatëvonesë në masën 1.8% çdo muaj, jo më shumë se 12 muaj mbi detyrimin si dhe ndërprerje të aktivitetit nga strukturat përkatëse.

KREU X
TAKSA E TABELËS

Neni 29

Fusha e zbatimit dhe kategorizimet

1. Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

2. Për qëllime të zbatimit të këtij vendimi, tabelat kategorizohen në:

- a. **Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo,** vendosen brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një table identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë, dhe si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës do shërbejë sipërfaqja në metër katror e të gjithë tabelave identifikuese të marra sëbashku.
- b. **Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit,** kanë formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.
- c. **Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme,** e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklam për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.
- d. **Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura,** tabela që pëdoren për panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

3. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga shkronja të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si: mur, fasadë e jashtme e çdo lloji, shtyllë, kolonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë e shkruar, e stampuar apo e pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, figurat, logot dhe simbolet që formojnë tabelën.

Neni 30
Niveli i taksës

Nivelet e taksës së tabelës, sipas kategorizimeve të përcaktuara në nenin 29, jepen në **aneksin nr. 3**, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Neni 31
Struktura dhe afatet për vjeljen e taksës

1. Detyrimi për taksën e vendosjes së tabelës referuar kategorive 1 dhe 2 është vjetor. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj, për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
2. Për kategoritë 1 dhe 2 për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës **31.07.2026** të vitit fiskal. Për subjektet që duan të identifikohen me tabelë të re pas datës **31.07.2026**, detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë për periudhën nga momenti i deklarimit.
3. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji pasardhës që subjekti regjistrohet pranë QKB dhe taksa paguhet menjëherë. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin, nga muaji pasardhës që regjistrohet pranë QKB.
4. Në rastin e më shumë se një tabele, pavarësisht nga vendndodhja, vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë me qëllime identifikuese, ndërsa tabelat e tjera do të konsiderohen si tabela me qëllime reklamuese.
5. Për kategorinë 1c për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës **31.07.2026**. Për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të bashkisë Elbasan.
6. Për kategorinë 1d detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të bashkisë Elbasan dhe paguhet menjëherë.
7. Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe shkronja, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produkteve apo shërbimeve që furnizohen nga vetë njësia, ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabele. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.
8. Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabele identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabele.
9. Institucionet e varësisë së Bashkisë Elbasan përjashtohen nga taksa për vendosjen e tabelës.
10. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregjeve.

TITULLI II

TARIFAT VENDORE

Neni 32

Llojet e tarifave

Bashkia Elbasan aplikon tarifat vendore si më poshtë:

- a. Tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit;
- b. Tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, shërbimit në tregje dhe zgjatjeve të orarit;
- c. Tarifa për zënien e hapësirave publike;
- d. Tarifa për dhënie licence për tregtim karburanti e lëndë djegëse;
- e. Tarifa të shërbimit administrativ të Bashkisë Elbasan;
- f. Tarifë për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime;
- g. Tarifa të institucioneve të varësisë.
- h. Tarifa për mirëmbajtjen e infrastrukturës në Njësitë Administrative.

KREU XI

TARIFA PËR MBROJTJEN DHE PËRMIRËSIMIN E MJEDISIT

Neni 33

Kategoritë e subjekteve

1. Ngarkohen me detyrimin për pagesën e tarifës për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit:
 - a. Subjektet VIP që ushtrojnë aktivitet prodhim metalesh nga skrapit ose minerali, shkrije e substancave minerale, përpunimi i naftës dhe nënprodukteve të saj, prodhimi i çimentos, që ndikojnë në mjedis, në vlerën 5,000,000 lekë/ vit.
 - b. Subjektet VIP që ushtrojnë aktivitet të tillë si: trajtimi i mbetjeve plastike dhe nënprodukteve, industria e peshkut dhe nënprodukteve, grumbullimi dhe asgjësimi i mbetjeve metalike, prodhim polisteroli, karrirë guri (gurore) apo aktivitete të tjera, që ndikojnë në mjedis, në vlerën 672,000 lekë/ vit.
 - c. Subjektet persona juridik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: karrirë guri (gurore), shfrytëzim të argjilave, shfrytëzim të lumenjve, që ndikojnë në mjedis, në vlerën 504,000 lekë/ vit.
 - d. Subjektet persona juridik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: industria e gomës dhe nënprodukteve të saj, prodhimi i polisterolit, industri të tjera, që ndikojnë në mjedis, në vlerën 336,000 lekë/ vit.
 - e. Subjekte juridike trajtimi mbetjeve plastike dhe nënprodukteve, grumbullimi dhe asgjëgjësimi mbetjeve metalike, grumbullim automjeteve të përdorura dhe servis, furrë buke, përpunimi i peshkut/mishit dhe nënprodukteve, tregti peshku, lavazhet, lyerje e automjeteve, fast-food, zgarë, zdrukthari, mobileri, përpunim mermeri, përpunim druri, riciklim e përpunim baterish, restorante, që ndikojnë në mjedis, në vlerën 37,500 lekë/ vit.

- f. Subjekte fizikë trajtimi mbetjeve plastike dhe nënprodukte, grumbullimi dhe asgjegjësimi mbetjeve metalike, grumbullim automjeteve të përdorura dhe servis, furrë buke, përpunimi i peshkut/mishit dhe nënprodukteve, tregti peshku, lavazhet, lyerje e automjeteve, fast-food, zgarë, zdrukthari, mobileri, përpunim mermeri, përpunim druri, riciklim e përpunim baterish, restorante, që ndikojnë në mjedis, në vlerën 12,000 lekë/ vit.
2. Subjektet që ngarkohen me këtë tarifë identifikohen nga D.T.T.V.T., referuar objektit të veprimtarisë që ato kryejnë në QKB dhe kontrollit faktik nga specialistët e terrenit.
3. Afati i pagesës së detyrimit është data **31.07.2026**.

KREU XII

TARIFAT E PASTRIMIT, GJELBËRIMIT, NDRIÇIMIT, SHËRBIMIT NË TREGJE DHE ZGJATJEVE TË ORARIT

Neni 34

Fusha e zbatimit, kategorizimet dhe mënyra e pagesës

1. Këto tarifa aplikohen për subjektet persona fizik/ juridik, vendas apo të huaj, ambulantët dhe familjarët, që ushtrojnë aktivitet ekonomik ose banojnë në territorin e Bashkisë Elbasan.
2. Kategorizimet e subjekteve jepen në **aneksin nr. 4** që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Detyrimi për tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore është vjetor.
4. Për kategorinë “Familjare” detyrimi paguhet në 12 këste mujore. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit. Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit.
5. Për kategorinë “Familjare” detyrimi llogaritet dhe paguhet për familje. Për të llogaritur detyrimin për tarifën, kjo kategori duhet të paraqesë pranë agentit tatimor përkatës dokumentin që vërteton gjendjen familjare aktuale, i lëshuar nga struktura kompetente brenda 3 muajve nga data e paraqitjes.
6. Për të gjitha kategoritë, përveç pikës 4 të këtij neni, afati për pagesën e tarifave është data **31.07.2026**.
7. Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet kamatëvonesë në masën 1.8% çdo muaj (deri në 12 muaj). Përfshihen nga kamatëvonesa tarifën e pikës 4.
8. Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
9. Për subjektet e reja që nisin veprimtarinë pas datës 31.07.2026, afati për pagesën e tarifave është **data 25 e muajit pasardhës nga momenti regjistrimit**.
10. Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer, përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal. Diferenca që rezulton i kthehet ose i kompesohet subjektit me rifillimin e aktivitetit.

11. Për kategorinë e parashikuar në aneksin 4, pika 5/c (lokale dasmash) lista me subjektet që ngarkohen me këtë tarifë vendoset në dispozicion të D.T.T.V.T., nga Inspektoriati i Mjedisit para datës **31.01.2026** dhe rast pas rasti për subjektet e reja.

Neni 34/1

Tarifa e Shërbimit në Tregje

1. Të gjithë subjektet që tregtojnë tek tregu industrial (lagjja “Shënkoll”), tregu i fruta perime (Namazjaja dhe markata tek ish Zyra e Punës), tek Rruga “Sul Misiri” (jo nga ana e fushës së vjetër të sportit), lagjja “Luigj Gurakuqi” (tek rruga “Mustafa Sahatçi”) trajtohen si ambulantë dhe i nënshtrohen tarifës sipas aneksit 4, pika 4.c.
2. Subjektet që tregtojnë në tregjet e Njërive Administrative mallra industriale, fruta-perime produkte bujqësore, blegtorale i nënshtrohen tarifës së shërbimit në tregje, sipas aneksit 4, pika 4a/b/c.
3. Në fillim të vitit realizohet inventarizimi i subjekteve që tregtojnë në tregje dhe marrin në përdorim banakët. Pas inventarizimit vijohet me procedurën e lidhjes së kontratës. Vlera e kontratës është sipas aneksit 4, pika ç. Në vazhdimësi, ndryshimet në kontrata depozitohen në Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregjeve, jo më vonë se 5 ditë nga momenti i ndryshimit të kontratës.
4. Subjektet që lidhin kontratë për përdorimin e banakëve dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 10% të vlerës së detyrimit.
5. Për të gjithë ata që tregtojnë fruta-perime, produkte bujqësore, artikuj industrial jashtë tregjeve i nënshtrohen tarifës ditore sipas aneksit 4, pika 4.c.
6. Struktura përgjegjëse për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Tregut dhe Menaxhimit të Parkimit Publik pranë D.T.T.V.T.

Neni 35

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

1. Sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, u nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.
2. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero).

3. Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore është e ngarkuar me vlerësimin dhe kontrollin e tatimpaguesve, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Neni 35/1

Niveli i tarifave

Nivelet e tarifave të pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, shërbimit në tregje dhe zgjatjeve të orarit, sipas kategorizimeve të përcaktuara në nenin 34, jepen në **aneksin nr. 4**, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

1. Për të gjithë subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim vjetor nga 0 deri në 8 milion lekë dhe me objekt veprimtarie: tregti, shërbim, prodhim, restorant, transport udhëtarësh dhe mallrash, tarifat e pastrim, gjelbërim dhe ndriçim do të përllogariten sipas niveleve të tarifave të aneksit 4 bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për të gjithë subjektet e tatimit mbi fitimin me qarkullim vjetor nga 8 deri në 14 milion lekë dhe mbi 14 milion lekë si dhe me objekt veprimtarie: tregti, shërbim, prodhim, restorant, transport udhëtarësh dhe mallrash, tarifat e pastrim, gjelbërim dhe ndriçim do të përllogariten sipas niveleve të tarifave të aneksit 4 bashkëngjitur këtij vendimi.

Neni 36

Lehtësira dhe përjashtime

1. Familjet me ndihmë ekonomike përjashtohen nga tarifa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe tarifa për mirëmbajtjen e infrastrukturës në njësitë administrative (aty ku aplikohet kjo tarifë referuar aneksit 4).
2. Familjet që figurojnë me banim në territorin e Bashkisë Elbasan, të regjistruar në regjistrat e Bashkisë Elbasan, por që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë përjashtohen nga tarifa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe tarifa për mirëmbajtjen e infrastrukturës në njësitë administrative (aty ku aplikohet kjo tarifë).
3. Personat me aftësi të kufizuar, invalidë, tetraplegjikë dhe paraplegjikë, të verbër, kur janë kryefamiljarë dhe nuk kanë persona të tjerë madhor në familje, me përjashtim të bashkëshortit/bashkëshortes, përjashtohen nga tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe tarifa për mirëmbajtjen e infrastrukturës në Njësitë Administrative (aty ku aplikohet kjo tarifë).
4. Institucionet e varësisë së Bashkisë Elbasan përjashtohen nga tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit.

5. Ambulantëve në tregjet e miratuara përjashtohen nga tarifa e pastrimit, e ndriçimit dhe gjelbërimit.
6. Subjektet me objekt veprimtarie turizmin (të tipit punime artizanale, shitje suvenire, bar-restorantë të kulinarisë tradicionale dhe të ngjashëm), që ushtrojnë aktivitetin e tyre brenda mureve perimetralë të territorit të Kalasë Elbasan dhe që janë deri 40 m², përjashtohen nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit. Për përjashtim duhet të paraqesin certifikatën e pronësisë dhe vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit.
7. Organizatat jofitimprurëse përjashtohen nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit. Për përjashtim duhet të paraqesin vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore që nuk kanë realizuar të ardhura të vitit të mëparshëm.

Neni 36/1

Dokumentacioni që dorëzohet për të përfituar nga përjashtimi

Kategoritë e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 36, për të përfituar këtë përjashtim, duhet të dorëzojnë pranë Sektorit të Taksave dhe Tarifave Familjare, zyrave të Njësive Administrative dhe Lagjeve të Bashkisë Elbasan sipas rastit dokumentet si vijon:

- ✓ Dokumentin që vërteton kushtin që sipas certifikatës familjare janë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, si dhe personave të tjerë madhorë të paaftë për punë (invalidë ose fëmijë nën 25 vjeç që ndjekin studimet).
- ✓ Librezën e invalidit, librezën e pensionit, vërtetimin e KMCAP, vërtetimin nga Njësia Administrative/lagjet për përfituesit e ndihmës ekonomike.
- ✓ Dokumentin, pasaportë, leje qëndrimi apo çdo dokument tjetër që vërteton që familja ka jetuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 37

Struktura për vjeljen e taksës dhe afati e pagesës

Strukturat e caktuara për vjeljen e këtyre tarifave janë:

- a. Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregjeve, për subjektet persona fizik/ juridik, vendas apo të huaj, ambulantët, që ushtrojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë Elbasan.
- b. Shoqëria “SHRUKË sh.a” sipas marrëveshjes dypalëshe me Bashkinë Elbasan dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Familjare, Njësia Administrative dhe Lagjet për familjet që banojnë në territorin e Bashkisë Elbasan.

KREU XIII

TARIFA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Neni 38

Baza dhe niveli i tarifës

1. Baza e tarifës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në metër katror, e cila kërkohet të shfrytëzohet nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.
2. Niveli i tarifës sipas kategorive dhe nënkategorive është sipas aneksit nr. 5, bashkëlidhur këtij vendimi. “Zona A”, zona “B” dhe zona “C”, për efekt tatimor janë zonat sipas hartës bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Detyrimi i tarifës përllëgaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqjes) me nivelet treguese të saj. Kjo tarifë paguhet sipas kushteve të përcaktuara nga D.P.P.D.U. në zbatim të Rregullores Arkitektonike të qytetit të Elbasanit miratuar nga Kryetari i Bashkisë me vendim nr.143, datë 03.03.2020 dhe përllëgaritjes së detyrimit nga D.T.T.V.T.
4. Pagesa e tarifës është vjetore. Afati i pagesës është data 28.02.2026.

Neni 39

Lehtësira dhe përjashtime

1. Subjektet që lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 12 mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 10% të vlerës së detyrimit.
2. Përjashtohet nga tarifa e zënies së hapësirës publike Bashkia Elbasan dhe institucionet e saj të varësisë, kur kjo hapësirë shfrytëzohet në përmbushjen e funksioneve të tyre publike.
3. Subjektet që kanë aktivitet ndihmës në shërbim të biznesit që lidhin kontratë për hapësirën publike ndodhur në zonën A, me afat 12 mujor vlera e së cilës kalon 1,000,000 lekë dhe e paguajnë të plotë në momentin e lidhjes së kontratës përfitojnë reduktimin e vlerës, duke e përllëgaritur në një shkallë mëposhtë të nivelit të tarifës pa kaluar në nivelin minimal të tarifës.
4. Subjekte të cilët kryejnë aktivitet në sheshet publike përjashtohen nga tarifat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të aneksit nr.5 pas lidhjes së marrëveshjes me Bashkinë Elbasan.

Neni 40

Struktura për mbledhjen e tarifës së hapësirës publike

Strukturat e caktuara për vjeljen e kësaj tarife janë Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregjeve dhe Njësitë Administrative.

KREU XIV TARIFAT E TRANSPORTIT

Neni 41

Tarifat vendore të transportit

1. Niveli i tarifave vendore të transportit sipas kategorive dhe nënkategorive është sipas **aneksit nr. 6**, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Transportit në Bashkinë Elbasan.

Neni 41/1

Tarifa orare e parkimit publik

1. Tarifa orare e parkimit, parashikuar në pikën 1.1, të aneksit 6, do të aplikohet në zonat në rrugët dhe sheshet publike të Bashkisë Elbasan, si dhe fashat orare ku do të realizohet shërbimi i parkimit me pagesë.
2. Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre detyrimeve do të jetë Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit, Ekonomik dhe Transportit dhe Policia Bashkiake në Bashkinë Elbasan.

Neni 42

Tarifa për licensa/autorizime/certifikata

1. Niveli i tarifave vendore të transportit sipas kategorive dhe nënkategorive është sipas **aneksit nr. 7**, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 30% e vlerës së plotë të tarifës.
3. Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Transportit në Bashkinë Elbasan.

Neni 43

Tarifa për dhënie liçense për tregtimin e naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre

1. Pagesa për dhënien dhe përtëritjen e liçensave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 1 000 000 (një milionë) lekë për licensa me afat pesëvjeçar. Për licensa të dhëna për një afat më pak se 5 vjet pagesa do jetë në raport me afatin për të cilin jepet (sipas përcaktimeve pika E aneksi 7). Në çdo rast afati duhet të jetë vit i plotë kalendarik.
2. Pagesa për dhënien dhe përtëritjen e liçensave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 100 000 (njëqind mijë) lekë. Kjo pagesë është e vlefshme për një periudhë pesëvjeçare.

3. Pagesa për dhënien dhe përtëritjen e autorizimit për hyrje-dalje në rrugë për stacionin e karburantit, është 2 000 (dymijë) lekë. Kjo pagesë është e përhershme.

Neni 43/1

Struktura për vjeljen e tarifës

1. Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit, Ekonomik dhe Transportit në Bashkinë Elbasan. (Aneksi 7).

KREU XV

TARIFAT VENDORE PËR UJITJEN DHE MIRËMBAJTJEN E RRJETIT KULLUES E UJITËS

Neni 44

Baza dhe niveli i tarifës

1. Kategoritë e tarifave janë:
 - a. Tarifë mirëmbajtje të sistemit të kullimit në vlerën 200 lekë/ dynym.
 - b. Tarifë mirëmbajtje të sistemit të ujitjes në vlerën 200 lekë/ dynym.
 - c. Tarifë ujitje me kanal të hapur, rrjedhje e lirë në vlerën 300 lekë/ dynym.
 - d. Tarifë ujitje me system të mbyllur tubacioni në vlerën 70 lekë/ dynym.
 - e. Tarifë ujitje me pompat private kur merr ujë nga kanali ujitës i fshatit në vlerën 200 lekë/ dynym.
2. Këto tarifa aplikohen në Njësitë Administrative.

Neni 45

Struktura për mbledhjen e tarifës për ujitjen dhe mirëmbajtjen e rrjetit kullues e ujitës

Strukturat e caktuara për vjeljen e kësaj tarife janë:

1. Sektori i Taksave dhe Tarifave Familjare, Njësitë Administrative dhe Lagjjet në bashkëpunim me strukturat e Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale.
2. Në ato fshatra ku Bashkia Elbasan nuk kryen shërbimin tarifa është 0 lekë. Mungesa e shërbimit vërtetohet me anë të një vërtetimi nga Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale.

KREU XVI
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT URBAN DHE PUNËVE PUBLIKE
Neni 46
Baza dhe niveli i tarifës

1. Kategoritë e tarifave janë:

- a. Tarifë aplikimi për çertifikatë përdorimi.
- b. Tarifë e hartimit të PDV për sipërfaqjen e pronës (gjatë lejes së ndërtimit).
- c. Tarifë aplikimi për leje zhvillimi.
- d. Tarifë aplikimi për leje ndërtimi.
- e. Tarifë aplikimi për deklarata paraprake të kryerjes së punimeve.
- f. Tarifë për certifikim relievi.
- g. Tarifë plan rilevimi.
- h. Tarifë fasade.
- i. Tarifë për dhënie dokumenta nga arkiva DPPDU.
- j. Tarifa kantieri brenda pronës.
- k. Tarifë për depozitimin e mbetjeve të ngurta.

2. Niveli i tarifave vendore të DPPDU-së sipas kategorive dhe nënkategorive është sipas aneksit nr. 8, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Faturat e lëshuara brenda vitit buxhetor për tarifën për aplikimet për deklarata paraprake për punime në sistemin e-leje është e vlefshme deri në 3 aplikime kur dy aplikimet e para janë refuzuar për mungesë dokumentacioni ose gabime materiale në shkresat e ngarkuara. Faturat e lëshuara brenda vitit buxhetor për tarifën për aplikimet për leje zhvillimi ose ndërtimi në sistemin e-leje është e vlefshme deri në 2 aplikime kur aplikimi i parë është refuzuar për mungesë dokumentacioni ose gabime materiale në shkresat e ngarkuara.

Neni 47
Struktura për mbledhjen e tarifave Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Urban dhe Punëve Publike

1. Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave sipas Aneksit 8 është Drejtoria e Planifikimit të Përgjithshëm dhe të Detajuar Urban dhe Drejtoria e Projektimit Urban në Bashkinë Elbasan.
2. Për pikën k. të nenit 48 të këtij vendimi, për tarifën e depozitimit të mbetjeve të ngurta në zbatim të V.K.B-së Nr.67, datë 23.05.2019 *“Për miratimin e tarifës që duhet të paguajnë subjektet dhe individët, për depozitimin e mbetjeve të ngurta”* përgjegjëse për vjeljen e saj do të jetë D.P.P.D.U., D.T.T.V.T., Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Bashkisë Elbasan dhe Inspektorati i Mjedisit si më poshtë:
 - a. Për aplikimet për leje ndërtimi tarifa për depozitimin e mbetjeve të ngurta do të përlllogaritet me vlerën 300 lekë/m³ sipas zërave të preventivit të ngarkuar në

sistemin e-leje përpara miratimit të lejes në fazën e përlllogaritjes së taksave dhe tarifave. Drejtoria e përgjegjëse për vjeljen e saj do të jetë D.P.P.D.U.

- b. Për aplikimin për deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve me miratimin e saj do të faturohet nga D.P.P.D.U. edhe tarifa për depozitimin e mbetjeve të ngurta me vlerë fikse 8000 (tetë mijë) lekë + 5000 (pesë mijë lekë) tarifë inertesh për subjektet zhvilluese të cilët janë të detyruar që të paguajnë me marrjen e njoftimit të miratimit të deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve. Një kopje e mandat pagesës do të dorëzohet nga zhvilluesi pranë IMT-së Elbasan brenda 7 ditëve kalendarike nga njoftimi i miratimit të deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve. D.P.P.D.U. rakordon çdo muaj IMT-në për deklaratat e miratuara. Nëse nuk është paguar brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim është Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit , Bashkia Elbasan përgjegjës për kontrollin dhe vjeljen e kësaj tarife dhe marrjen e masave apo aplikimin e sanksioneve.
- c. Për vetëdeklarimet sipas formularit të Bashkisë Elbasan, për punimet e parashikuara në nenin 6 të VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregulloren së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar, vetëdeklaruesit do të pajisen me formularin përkatës vetëm pasi të dorëzojnë pranë Rajonit apo Njësisë Administrative të Bashkisë Elbasan tarifën për depozitimin e mbetjeve të ngurta me vlerën 3000 (tre mijë) lekë sipas faturës të lëshuar sipas rasteve të parashikuara:

c.1 Sipas faturës së lëshuar nga Rajonet apo Njësitë Administrative përkatëse ku do kryhen punimet vetëm pas pagesës të mandatit së tarifës për depozitimin e mbetjeve të ngurta nga subjekti vetëdeklarues në filialet e Postës Shqiptare dega Elbasan ose një Bankë të Nivelit të Dytë.

c.2 Subjekte të tjera (fizike ose juridike) që gjenerojnë mbetje inerte si pasojë e objektit të veprimtarisë që ushtrojnë janë të detyruar të bëjnë vetëdeklarimin mbi sasinë të gjeneruara dhe të pajisen me faturën për pagesën e tarifës së mbetjeve inerte pranë Drejtoria e Taksave,Tarifave Vendore dhe Tregjeve, Bashkia Elbasan. Sektori i Mjedisit Elbasan ka detyrë monitorimin dhe kontrollin e vjeljes së kësaj tarife.

Në çdo rast pagesa e tarifës për depozitimin e mbetjeve të ngurta nuk heq detyrimin e zhvilluesit ose operatorit ekonomik që mbetjet ndërtimore, t'i depozitoj në jug të fshatit Vidhas, Njësia Administrative Papër, në truall shtet, me nr. Pasurie 52/26 me kapacitet maksimal 1.000.000 ton/vit nën juridiksionin e Bashkisë Elbasan në zbatim të V.K.B-së nr.66, datë 23.05.2019.

Përfaqësuesi i subjekteve fizik/juridik apo individ do të paraqesë mandatin e pagesës së kryer për tarifën e mbetjeve të ngurta në momentin e depozitimit të mbetjeve të ngurta në vendin e përcaktuar.

KREU XVII
TARIFA TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË

Neni 48
Tarifa për Qendrën e Artit

Qendra e Artit, aplikon këto tarifa:

- a. Për përdorimin e sallës së teatrit “Skampa” për qëllime artistike, 15,000 lekë/ ditë.
- b. Për përdorimin e sallës së teatrit “Skampa” për qëllime artistike dhe bamirësie për të cilat nuk shiten bileta nga subjekti organizator 10,000 lekë/ ditë.
- c. Për përdorimin e sallës së teatrit “Skampa” për qëllime jo artistike, 15,000 lekë/ orë.
- d. Për përdorimin e sallës së teatrit të kukullave 5,000 lekë/ ditë.
- e. Për shfaqje në teatër muzike varion 200 deri në 1,000 lekë/ bileta. Për studentët, invalidët dhe pensionistët kjo tarifë është sa 50 % e vlerës.
- f. Për shfaqje në teatrin e kukullave 100 lekë/ bileta.
- g. Për foni dhe ndriçim është 15, 000 deri në 50,000 lekë/ aktivitet.

Neni 49
Tarifa për Drejtorinë e Përgjithshme të Kulturës dhe Sportit

Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit, aplikon këto tarifa:

- a. Për hyrje në vende muzeale për të rritur 200 lekë/ bileta.
- b. Për hyrje në vende muzeale për nxënës, studentë, invalid dhe pensionist 50 lekë/ bileta.
- c. Për dhënie me qira të kostumeve tradicionale 1,000 lekë/ kostum/ ditë.

Neni 50
Tarifa për Klubin Shumësportësh

Klubi Shumësportësh, aplikon këto tarifa:

1. Për përdorim salle të pallatit të sportit:

a.Ndeshje	10.000 lekë/ora
b.Stërvitje	40.000 lekë/ora
c.Bamirësi	0 lekë/ora
d.Panaire, koncerte,takime elektorale etj.	100.000 lekë/ora
2. Për përdorimin e kompleksit sportiv “Shefqet Lamçja”:

a.Ndeshje	5000 lekë
b.Stërvitje	3000 lekë
3. Për përdorimin e stadiumit “Elbasan Arena”:

a.Ndeshjet e Kampionatit Kombëtar/ ndeshje pa ndriçim	300,000 lekë
---	--------------

b.Ndeshjet e Kampionatit Kombëtar/ ndeshje me ndriçim 500,000 lekë

4. Përfshihen nga tarifat për përdorimin e stadiumit "Elbasan Arena":
 - a.Ekipi i Elbasanit, AF ELBASANI
 - b.Rastet përjashtimore referuar akt marrëveshjes nr.1090/4 prot., datë15.04.2024 lidhur midis FSHF-së dhe Bashkisë Elbasan.

Neni 51

Tarifa për Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parashkollor

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parashkollor, aplikon këto tarifa:

- a. Për ushqim në çerdhe është 200 lekë/ ditë.
- b. Për ushqim në kopësht është 200 lekë/ ditë.

Përfshihen nga këto tarifa:

- a. Fëmijë të moshës 0-6 vjeç, të familjeve monoprinçerore që përfitojnë ndihmë ekonomike, ku kujdestarja/i ligjor është i/e ve, e/i divorcuar ose beqar/e;
- b. Fëmijë të moshës 0-6 vjeç, në statusin jetim, që i përkasin familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike.

Neni 52

Struktura për mbledhjen e tarifave të institucioneve të varësisë

1. Struktura të caktuara për mbledhjen e tarifave të institucioneve të varësisë janë përkatësisht:
 - a. Qendra e Artit për tarifat e nenit 48,
 - b. Qendra e Trashëgimisë Kulturore për tarifat e nenit 49,
 - c. Klubi Shumësportësh për tarifat e nenit 50,
 - d. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parashkollor për tarifat e nenit 51.
2. Tarifat e parashikuara në nenet 48/d, 48/f, 50/a dhe 50/b miratohen nga bordi artistik.

KREU XVIII
TARIFA E SHËRBIMIT FUNERAL

Neni 53

Baza, niveli i tarifës dhe struktura e ngarkuar për vjeljen e detyrimit

1. Tarifat e shërbimit funeral përcaktohen në **aneksin nr. 10**, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Agjencia e Shërbimeve Publike.

KREU XIX
TARIFAT VENDORE PËR SHFRYTËZIMIN E TRUALLIT PUBLIK PËR
TUBACIONET, KABLLOT TELEFONIKE DHE FIBRËN OPTIKE

Neni 54

Kategoritë për shfrytëzim të truallit publik për tubacione të ujrave të bardha e të zeza,
kabllot telefonike, fiber optike (nëntokësor dhe ajror)

1. Tarifë për shfrytëzim të truallit publik për tubacione të ujrave të bardha e të zeza për:
 - a. tubacion uji i pijshëm, diametri $> 200 \div 600$ mm është 20 lekë/ml/vit,
 - b. tubacion uji i pijshëm, diametri $> 80 \div 200$ mm është 10 lekë/ml/vit,
 - c. tubacion uji i pijshëm, diametri $\div 80$ mm është 5 lekë/ml/vit,
 - d. tubacion i ujrave të zeza, diametri < 200 mm është 2 lekë/ml/vit,
 - e. tubacion i ujrave të zeza, diametri $> 200 \div 600$ mm është 3 lekë/ml/vit,
 - f. tubacion i ujrave të zeza, diametri > 600 mm është 5 lekë/ml/vit.
2. Tarifë për shfrytëzim të truallit publik për kabllot telefonike, fiber optike (nëntokësor dhe ajror) është 30 lekë/ml/vit.
